



Federal Ministry
for Economic Affairs
and Energy

PARTNERITETI INSTITUCIONAL

Forcimi i mëtejshëm i
aftësive trajnuese të
Institutit të Kosovës për
Administratë Publike
(IKAP)



Organizatrat partnere

Ministria Federale e Çështjeve Ekonomike dhe Energjisë
(BMWİ)
Berlin, Gjermani

Ministria e Administratës Publike (MAP)
Prishtinë, Kosovë

Ministria e Integritit Evropian (MIE)
Prishtinë, Kosovë

Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP)
Prishtinë, Kosovë

Zyra e Projektit:

Flordi Dobruna, Asistent Projekti

Telefon: +383 (0) 43 538378

Flordi.Dobruna@rks-gov.net

Instituti i Kosovës për Administratë Publike

Kompleksi Rilindja, Kontejneri Nr. 3

10000 Prishtinë



Partneritet institucionale

Partneritetet institucionale janë një qasje e re që po ndërmerren nga Ministria Federale për Çështje Ekonomike dhe Energji (BMW-i). Qëllimi është që të vendosen ekspertë të veçantë nga Ministria, agjensitë e saj ose institucione të tjera që lidhen me projektin, për të mbështetur proceset e reformave dhe modernizimin e strukturave administrative në vendet e zgjedhura partnere. Instrumentet e BE-së, Binjakëzimi dhe TAIEK (Asistenca Teknike dhe Shkëmbimi i Informacionit) janë modelet e roleve për partneritetet institucionale. Partneriteti institucional midis BMW-i-së dhe IKAP-it është i pari që do të zbatohet në rajon. Ai bazohet në një Deklaratë të Përbashkët të Qëllimit midis BMW-i-së dhe tre institucioneve partnere të Kosovës.

Partneriteti BMW-i me IKAP bazohet në rezultatet e një projekti të mëparshëm të Binjakëzimit të BE-së. Me partneritetin pasues institucional, rezultatet duhet të sigurohen dhe të zhvillohen më tej. Për të promovuar më tej trajnimin në lidhje me BE-në, do të trajnohen rreth 25 trajnerë. Së bashku me trajnerët, do të hartohen dhe zbatohen programet mësimore për kapituajt e zgjedhur të acquis të BE-së. Zhvillimi i përshtatur i një sistemi elektronik të menaxhimit të mësimit mbështet aftësinë e menaxhimit të IKAP-it.

Duke filluar nga shtatori 2019, rreth 40 misione ekspertësh do të vendosen në Prishtinë nga data 19 shtator deri në 20 shtator për të forcuar aftësitë e trajnimit të IKAP-it. Bashkëpunimi me MAP-in dhe MIE-n, si dhe me organizatat ndërkombëtare të zhvillimit do të kontribuojë në suksesin e projektit në kontekstin e reformave të vazhdueshme administrative në Kosovë.

Ekipi i Projektit

Znj. Refike Sülçevsi

Drejtoreshë e Përgjithshme e IKAP-it

Z. Enver Haxhijaj

Drejtor i Trajnimit të IKAP-it & Drejtuesi i projektit të IKAP-it

Z. Bujar Thaçi

Drejtori Administrativ i IKAP-it

Z. Hetem Idrizi

Menaxher i Programit dhe Teknologjisë së Informacionit të IKAP-it

Prof. Dr. Klaus Erdmann

Universiteti Federal i Administratës Publike dhe Drejtuesi i Projektit Gjerman

Znj. Sabine Reinkober

Ministria Federale e Çështjeve Ekonomike dhe Energjisë/
Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ),
Menaxhere e Projektit

Z. Flordi Dobruna

Asistent Projekti

Mbledhje Pune e Projektit me Menaxhimin e IKAP-it



Qëllimet e projektit

- të përmirësojë sistemin e koordinimit ndërinstitucional për trajnime të lidhura me BE-në dhe MSA-në,
- të forcojë zhvillimin e trajnimit dhe aftësitë e menaxhimit të IKAP-it për zbatimin e trajnimeve të lidhura me BE-në dhe MSA-në,
- të mbështesë linjën e veprimit të trajnimit dhe planifikimin strategjik të IKAP-it.

Objektivat kryesore të projektit

- Të zhvillohet Rregullorja e Trajnimit me një sistem të përmirësuar koordinimi për trajnime të lidhura me BE-në.
- Të përmirësohen kapacitetet e zhvillimit të trajnimit të IKAP-it.
 - Të zhvillohet paketa standarde e trajnimit për Trajnimin e Trajnerëve.
 - Të hartohet dhe të zbatohet programi mësimor për module të trajnimit të MSA-së dhe BE-së.
 - Të përpunohen modulet e Trajnimit të Hyrjes.
- Të hartohen udhëzimet për trajnuesit.
- Të drejtohet vlerësimi i ndikimit.

Objektivat kryesore të projektit

- Aftësitë e përmirësuara të menaxhimit të trajnimit të IKAP-it.
 - Struktura organizative e rishikuar.
 - Programi i përgjegjësive i hartuar.
 - Plani qendror i skedarit i përpunuar.
- Mbështetje për zhvillimin e mësimit elektronik.
 - Krijimi i sistemit të menaxhimit të mësimit ILIAS për IKAP-in.
- Kapaciteti i përmirësuar i IKAP-it për planifikim dhe marrëdhënie me publikun.
 - Programi vjetor i trajnimit i hartuar.
 - Buletini i IKAP-it i zhvilluar.

Imprint

Publisher

Federal Ministry for
Economic Affairs and Energy
Public Relations Division
11019 Berlin
www.bmwi.de

Status

October 2019

Print

BMWi

Design

PRpetuum GmbH, 80801 Munich

Illustrations

FrankRamspott / iStock / title
Qiang Erdmann-Xin / p. 4

